

AKT THEMELUES

I SHOQERISE TREGTARE PRIVATE

"R Farm Distribution" SH.P.K.

Në bazë të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare e Biznesit" dhe të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", me vullnetin tim të lirë, të shprehur në nënshkrimin e Aktit Themelues :

Unë Rei Kaci, i biri i Arjanit, dtl 11.03.1997 me ID J70311047D, banues ne Tirane, sot më datë 14.01.2020, hartoj Statutin e shoqërisë si më poshtë :

FORMIMI

NENI 1

Formohet shoqëria private e quajtur "**R Farm Distribution**" sh.p.k. Shoqëria do ti nënshtroht legjislacionit shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do ti nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega.

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortaku themelues.

SELIA E SHOQERISE

NENI 2

Selia e shoqërisë tregtare private "**R Farm Distribution**" sh.p.k. do të jetë: Njësia Administrative Nr.4, Rruga e Dibrës, Kompleksi "ORION 3", Kati 1

Ajo mund të çelë dhe seli të tjera të dyta, degë e filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe me miratim të organve kompetente edhe jashtë vendit.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, dege, të krijojë filiale si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendimin e ortakut themelues të saj.



OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 3

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në fushën e:

1. Import-eksport, shitje me shumice dhe pakice të produkteve farmaceutike, kozmetike etj.
2. Tregtimit me shumicë e pakicë dhe import-eksport të mallrave industriale, ushqimore, lëndë të para.

NENI 4

Për kryerjen e veprimtarisë së saj shoqëria do të sigurojë mjetet e nevojshme dhe do të bashkëpunojë me persona fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 5

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare private "**R Farm Distribution**" sh.p.k. do të jetë **100.000** (njqind mijë) lekë dhe do të përbëhet nga kuota e ortakut themelues të shoqërisë. Kapitali përbëhet nga **1** kuota dhe vlera nominale e një kuote është e barabartë me **100 000** lekë Kapitali themeltar fillestar mund të shtohet sipas vendimit të ortakut themelues. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm.

NENI 7



Ortaku i vetëm duhet të bëjë përpjekje për rritjen e potencialit ekonomik të shoqërisë, të ruajë sekretin e saj dhe të mos dëmtojë interesat e personave të tjerë dhe të shoqërisë.

DREJTIMI I SHOQERISE

NENI 8

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, Z. Rei Kaci, i cili është përfaqësues ligjore i saj. Afati i emërimit të administratorit është për një periudhë kohore prej 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

NENI 9

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakut themelues të shoqërisë.

NENI 10

Ortaku themelues ka të drejtë të emërojë dhe administratorë të tjerë të vlerave materiale të shoqërisë. Ai ka të drejtë të caktojë financiar, likuidator për problemet e shoqërisë, si edhe të pajtojë persona të tjerë si ortakë. Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, për aktivitetin e kryer të shoqërisë.

NENI 11

Konfliktet që mund të lindin midis palëve do të gjykohen dhe zgjidhen në zbatim të legjislacionit shqiptar në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 12

Shoqëria ka vulën e saj në madhësi të zakonshme, me tekstin për rrethin e saj.

NENI 13

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe veçanërisht të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ”.

NENI 14



Ky akt themelimi përpilohet në tre kopje me vlerë të barabartë, nga të cilat njëra depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, njëra në zyrën e Tatimeve dhe kopja e tretë mbahet në dokumentat e shoqërisë tregtare "R Farm Distribution" sh.p.k.

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortaku themelues.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE

"R Farm Distribution" sh.p.k

Rei Kaci

